



Kanton Bern  
Canton de Berne

**hallo-bern.ch**  
**salut-berne.ch**

## **Siguria sociale**

Sistemi i sigurimit social

Masë paraprake për pleqëri

Invaliditeti

Papunësia

Sigurimi për sëmundje dhe aksident

Pushimi për nëna dhe familja

Ndihma sociale

**hallo-bern.ch**

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri  
Siguria sociale



## Sistemi i sigurimit social

Banoret dhe banorët e Zvicrës janë të mbrojtur përmes sigurimit social prej rreziqeve të ndryshme. Sigurimet ndihmojnë për shembull atëherë, kur dikush e humb punën e tij apo sëmuret. Mirëpo ato mbështesin edhe familjet edhe njerëzit e vjetër.

### Parimet

Sigurimet sociale financohen nga banoret dhe banorët zviceran. Këtu vlen principi i solidarizimit: Shumica e popullit paguan, përgjatë i vetmi apo grupe të caktuara mbështeten. Sigurimet sociale në përgjithësi janë të detyrueshme. Kontributet zbriten prej të punësuarve direkt nga rroga. Mirëpo edhe punëdhënëset dhe punëdhësit, të pavarurit dhe të pa punët japin kontribut financiar.

### Shërbimet

Sigurimet sociale i mbështesin njerëzit në situata të caktuara jetësore. Ato paguajnë para ditore, pensionet, apo shtesat apo i marrin përsipër shpenzimet e caktuara të sëmundjet dhe aksidentet. Sigurimet sociale janë të gjitha me ligj të rregullura.

### Kur mbështetet njeriu?

- Në pleqëri, në rast vdekje dhe invaliditeti ( 3 shtyllat: AHV/IV | AVS/AI, masë paraprake në profesion, masë paraprake private).
- Te sëmundja dhe aksidenti (sigurimi për sëmundje dhe aksidente)
- Te pushimi i lindjes (pagesa e pushimit të lindjes)
- Te pa punësia (sigurimi për të papunët)
- Kur njeriu ka fëmijë (shtesat e fëmijëve)

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/sistemi-i-sigurimit-social](http://www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/sistemi-i-sigurimit-social)



## Masë paraprake për pleqëri

Me masë paraprake për pleqëri është e sigurt, që të pensionuarve ju mbeten mjaft para për të jetuar. Sistemi zviceran me masë paraprake ka tri shtylla: Sigurimin e pensionit në pleqëri /AHV (Alters- und Hinterlassenenversicherung, AHV | assurance-viellesse et survivants, AVS), masë paraprake (arka e pensionit) dhe masë paraprake vullnetare për pleqëri (shtylla e 3.)

### Sigurimi i pensionit në pleqëri (1. Säule | 1er pilier)

Sigurimi i pensionit në pleqëri (Alters- und Hinterlassenenversicherung, AHV | assurance-viellesse et survivants, AVS) është një institut shtetëror. Shumica e personave të rritur duhet për këtë të paguajnë. Shumat zbriten te të punësuarit çdo muaj direkt nga rroga, punëdhënësi merr përsipër gjysmën. Të pavarurit apo personat pa vend pune duhet të njoftohen në filialet në komunë e banimit (AHV-Zweigstelle der Wohngemeinde | l'agence AVS de votre lieu de domicile) si duhet t'i paguajnë kontributet e tyre. AHV ju paguan pensionerëve një pension në muaj. Lartësia e pensionit mvaret prej shumës e cila është paguar. AHV i mbështetë edhe në rast vdekje bashkëshortët dhe fëmijët e personit të vdekur (Pension për të veja dhe jetimët). Secili dhe secila posedon një letërnjoftim -AHV me numrin e sigurimit personal.

### Masë paraprake profesioni (2.Säule | 2éme pilier)

AHV (pensioni) zakonisht nuk është i mjaftueshëm, mbas pensionimit të vazhdohet jetja tutje si më parë. Për këtë eksizton për të punësuarit edhe një masë paraprake në profesion arka/trusti pensional, (Pensionskasse | caisse de pension), e cila mbushet prej një shume të ardhurave vjetore dhe është e detyrueshme. Shumat zbriten përmuajshëm direkt nga rroga, punëdhënësi duhet s`paku gjysmën ta paguaj. Të pavarurit nuk duhet të paguajnë. Ata mund këtë ta bëjnë vullnetarisht, për këtë janë vetë përgjegjës. Meqë në arkën e pensionit janë para të kursyera, në pleqëri paguhen ose si pension ose mund të tërhiqen menjëherë. Në raste të caktuara munden parat edhe më herë të tërhiqen: Kur njeriu e themelon një firmë të veten, kur shpërngulet nga Zvicra, kur njeriu e ndërton një shtëpi për vete apo e blen një banesë.

### Masë vullnetare paraprake e pleqërisë ( 3. Säule | 3e pilier)

Te shtylla e 3. (3. Säule) bëhet fjalë për një masë paraprake private vullnetare për pleqëri, e cila shpërblehet në përllogaritjen e tatimit. Kjo mundet të bëhet në banka apo sigurime. Preferohet në shtyllën e 3. me kursye para në mënyrë që në pleqëri njeriu të ketë rezervë.



## Shërbimet plotësuese

Njerëzit e vjetër, që megjithë AHV dhe arkës pensionale nuk kanë para të mjaftueshme të jetojnë, kanë sipas rrethanave të drejtën financiare të shërbimeve plotësuese (Ergänzungsleistungen | prestations complémentaires). Për duhet të aplikohet në filialen e komunës për AHV. Është qartë e rregulluar, kush ka të drejtën e shërbimeve financiare plotësuese. Shërbimet plotësuese financohen prej taksa pagueseve dhe taksa pagesit.

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/mase-paraprake-per-pleqeri](http://www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/mase-paraprake-per-pleqeri)



## Invaliditeti

Kush nuk punon gjatë për arsye shëndetësore, apo mund të punoj vetëm pjesërisht, ka sipas rrethanave të drejtën për mbështetje financiare përmes sigurimit invalidor (Invalidenversicherung IV | assurance invalidité AI). IV nuk paguen vetëm para. Ai i mbështet të siguarit para s`gjithash te hyrja apo rihyrja në punë.

### Sigurimi invalidor

Sigurimi invalidor (IV) është institucion i shtetit. Shumica e personave të rritur duhet për këtë të paguajnë shuma. Shumat zbriten prej të punësuarve çdo muaj prej rrogës, punëdhësi merr përsipër gjysmën. Të pavarurit apo personat pa vend pune duhet te kasa për kompensim AHV-në filialen e komunës të njoftohen, si duhet t`i paguajnë shumat e tyre.

### Mbështetja përmes sigurimit invalidor

Të drejtë për mbështetje nga IV kanë personat, që më s`paku një vit shkaku i arsyeve shëndetësore (psiqike apo fizike) nuk kanë punuar fare apo vetëm pjesërisht. IV paguan në formën e një pensioni mujor. Mirëpo kjo bëhet vetëm atëherë, kur të siguarit shkaku i kufizimeve nuk mundën më të riaftësohen për punë. Më parë IV mbështet personat invalid, që ta gjejnë një punë të përshtatshme. Për mbështetje nga IV- duhet të aplikohet në zyrën-IV të kantonit të Bernit.

### Shërbimet shtesë

Personat, të cilët megjithë mbështetjes nga IV apo dhe të ardhura të tjera (p.sh. pensioni) kanë pak para për të jetuar, kanë sipas rrethane të drejtën për shërbime shtesë financiare (Ergänzungsleistungen | prestations complémentaires). Për këtë duhet të aplikohet në filialet e AHV-në komunën e banimit. Është qartë e rregulluar kush e gëzon të drejtën për shërbimet shtesë. Shërbimet shtesë financohen nga tatim pagueset dhe tatim paguesit.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/invaliditeti](http://www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/invaliditeti)

## Papunësia

Të gjithë të punësuarit të cilët banojnë në Zvicër, janë të siguruar kundër papunësisë. Kush mbetet i papunë, merr sipas rregullit përgjatë një kohe të caktuar mbështetje financiare. Të papunët duhet të lajmërohen në qendrat rajonale ndërmjetësuese për punë (RAV | ORP). Kjo ju ndimon përgjatë kërkimit të një pune.

### Sigurimi i të papunëve

Sigurimi i të papunëve (ALV | AC) është një sigurim shtetëror dhe për të gjithë të punësuarit i detyrueshëm. Shumat mujore zbriten direkt nga rroga, punëdhënësi merr gjysmën përsipër. Të pavarurit nuk mundën të sigurohen te sigurimi i të papunëve. Kush mbet pa punë, merr prej një kase për të papunët një pagë mujore zëvendësuese para për të papunët, (Arbeitslosengeld | allocation chômage). Nëse, kur, dhe në çfarë shume paguhen parat për të papunët, mvaret prej shumë faktorëve. Për shembull, sa gjatë ka punuar njeriu, apo për çfarë arsye ka mbetur i pa punë.

### Veprimi gjatë papunësisë

Kush mbetet pa punë, duhet sa më shpejt që është e mundur të lajmërohet në komunën ku banon. Ideale është këtë e bënë njeriu para ditës të fundit të punës, më s`voni në ditën e parë të papunësisë. Paralelisht duhet patjetër të lajmërohet njeriu te qendra përkatëse rajonale për ndërmjetsim për punë (RAV | ORP). Aty ju sqarohet e gjithë procedura.

### Qendra rajonale e ndërmjetësimit për punë

Qendra rajonale e ndërmjetësimit për punë (RAV | ORP) ndihmon në atë, për ta gjetë përsëri shpejt një punë. Bisedat këshilluese në RAV | ORP janë të detyrueshme, kur njeriu tërheq para për të papunët. RAV | ORP ofron edhe kurse dhe programe për veprimtari. Këto janë pjesërisht po ashtu të detyrueshme. Edhe personat, që kurr nuk kanë punuar në Zvicër dhe kërkoj një punë, mundën të lajmërohen në RAV | ORP. Mirëpo ata nuk marrin para.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/papunesia](http://www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/papunesia)



## Sigurimi për sëmundje dhe aksident

Kush banon në Zvicër, duhet ta ketë një sigurim për aksident- dhe një sigurim shëndetësor. Këto sigurime private i heqin shpenzimet, te aksidentet, sëmundja apo shtatzënësia. Të dy sigurimet duhet të bëhen në tre muajt e parë pas ardhjes në Zvicër.

### Sigurimi shëndetësor me përkujdesje (sigurimi bazë)

Të gjitha banoret dhe banorët në Zvicër duhet patjetër vetë ta bëjnë një sigurim shëndetësor me përkujdesje -sigurim bazë, (Grundversicherung | assurance de base). Kush vendoset në Zvicër, ka për këtë tre muaj kohë. Nëse njeriu sëmurët në këtë kohë ende pa e përmbyll sigurimin, shpenzimet e bëra kërkohen më pastaj. Sigurimi bazë ofrohet prej shumë sigurimeve shëndetësore private (Krankenkassen | caisses-maladies privées). Zgjedhja e një sigurimi shëndetësor është e lirë. Sigurimet shëndetësore duhet t`i marrin të gjithë personat që jetojnë në Zvicër. Të siguruarit paguajnë një shumë mujore. Këto shuma janë të ndryshme dhe të larta sipas sigurimit shëndetësor, modelit të sigurimit, për këtë e vlen të krahasohen ofertat. Sigurimet shëndetësore mundet njeriu vetëm një herë në vit t`i ndërroj (nëntor). Sigurimi bazë nuk i merr vetëm shpenzimet kur njeriu është i sëmurë, ai e paguan edhe shtatzënësin dhe lindjen. Shërbimet janë të rregulluara me ligj. Kujdes: Shpenzimet për mjekimin e dhëmbëve apo syzet zakonisht duhet të paguhet vetë.

### Sigurimi për aksidente

Të punësuarit janë automatikisht të siguruar kundër aksidenteve gjatë punës dhe në kohën e lirë përmes punëdhënësit, nëse punojnë më shumë se 8 orë në javë. Kush punon më pak, nuk është i siguruar kundër aksidenteve në kohën e lirë dhe duhet vetë të përkujdeset për sigurim kundër aksidentit. Kjo vlen edhe për të pavarurit dhe të gjithë personat që nuk janë në marrëdhënie pune, ata duhet të sigurohen kundër aksidentit te një sigurim shëndetësor. Të pavarurit mundet edhe te sigurimet e tjera ta bëjnë një sigurim kundër aksidentit. Të siguruarit duhet të paguajnë premin mujore. Te të punësuarit zbritet direkt nga paga.



## Lirimi i premive (shumës)

Kush nuk mundet ta paguaj sigurimin shëndetësor, ka sipas rrethanave të drejtën për zbritjen e premis (Prämienverbilligung | réduction de primes d'assurance-maladie) nga sigurimi bazë. Për me marr këtë zbritje, njeriu duhet çdo vit deri më 31. dhjetor ta bëjë një kërkesë. Nëse kjo lejohet, paguan njeriu në vitin e ardhshëm më pak premi. Për personat që më vonë kanë ardhë në kanton, vlejnë rregulla speciale. Zyra për sigurime sociale ( Amt für Sozialversicherungen, ASV | Office des assurances sociales, OAS) informon për zbritjen e premis dhe e merr online kërkesën për zbritje.

## Sigurimi plotësues për sigurimin bazë

Vullnetarisht munden të siguri shëndetësor bazë i detyruar të bëhen sigurime të ndryshme plotësuese (Zusatzversicherungen| assurances complémentaires). Këto i mbulojnë shërbimet të cilat nuk mbulohen nga sigurimi bazë, p.sh, mjekimi i dhëmbëve. Sigurimet plotësuese ofrohen po thuajse prej të gjitha sigurimeve shëndetësore. Sigurimet shëndetësore mund të vendosin vetë, a dëshirojnë dikë ta sigurojnë apo jo, dhe mund të paraqesin kushte.

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/sigurimi-per-semundje-dhe-aksident](http://www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/sigurimi-per-semundje-dhe-aksident)





## Pushimi për nëna dhe familja

Kush ka fëmijë në Zvicër, finanziahet për fëmijë dhe merr shtesat për arsimim. Gratë që punojnë kanë me lindjen e fëmijut të drejtë për një pushim me pagesë deri në 14 javë.

### Pagesa e pushimit të nënave

Gratë, që janë të punësuar kanë zakonisht të drejtë pas lindjes të fëmijut për pushim me pagesë (Mutterschaftsurlaub | congé maternité ) prej 14 javësh. Në këtë kohë ju paguhet atyre zakonisht 80 përqind e pagës. Ato që nuk punojnë apo ato që janë të pa afta për punë duhet të shkojnë te kasa e kompensimit caktuar për sigurime si AHV në kantonin e Bernit (Ausgleichskasse des Kantons Bern | caisse de compensation du canton de Berne) dhe të njoftohen se a e gëzojnë edhe ato këtë të drejtë. Këtu ka rregulla speciale. Përgjatë tetë javët e para pas lindjes nënat nuk guxojnë të punojnë (mbrojtja e nënave).

### Pushimi për baba

Pushim me pagesë. Përkundër pushimit të lindjes për nëna pushimi për babatë është fleksibil: Njeriu mund përnjëherë apo me ditë ta shfrytëzoj pushimin. Kjo vlen mbrenda 6 muorit të parë të lidjes të fëmijut.

### Shtesat e familjes

Kush ka fëmijë, mbështetet financiarisht me shtesa të familjes (Familienzulagen | allocations familiales). Këto paguhen si shtesa për fëmijë deri në moshën 16 vjeçare dhe për të rinjë në arsimim deri në moshën 25 vjeçare. Të drejtë për këtë kanë prindërit, që punojnë (edhe të pavarurit), apo prindërt që nuk punojnë dhe kanë pak para. Te të punësuarit paguhen shtesat e fëmijëve në muaj me pagë. Informacione të tjera për shtesa të familjes japin punëdhënësit apo degët e komunave në institucionet e sigurimeve sociale. Shuma e shtesave të familjes është në kantone e ndryshme.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/pushimi-per-nena-dhe-familja](http://www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/pushimi-per-nena-dhe-familja)



## Ndihma sociale

Ndihma sociale mbështet njerëzit, që nuk kanë para të mjaftueshme për të jetuar dhe ata që nuk marrin apo marrin shumë pak mjete financiare prej sigurimeve sociale. Nuk ka të bëjë me një sigurim, por me një mbështetje nga shteti.

### Ndihma sociale

Ndihma sociale (Sozialhilfe | aide sociale) i mbështet njerëzit në Zvicër, të cilët kanë ra në mjerim financiar. Ajo mbulon shpenzimet minimale për jetë. Pranë ndihmës financiare ofron edhe këshillime. Qëllimi është që njerëzit mundësisht ekonomikisht shpejt përsëri të pavarësohen. Ndihma sociale nuk paguan kur dikush merr mjaftueshem ndihmë tjetër financiare, me e financue jetën e tij-si p.sh. paratë për të papunët, pensionet, pagat, apo mbështetje nga të njohurit. Ajo nuk paguan as borxhet. Parat duhet të kthehen, kur njeriu posedon përsëri mjete të mjaftueshme financiare. Ndihma sociale finanziahet nga tatim pagueset dhe tatim paguesit.

### Aplikimi për ndihmë sociale

Kush don të aplikoj për ndihmë sociale drejtohet te shërbimi social (Socialdienst | service social) i komunës. Aty duhet njeriu hapur të paraqesë të ardhurat dhe pasurin e tij. Pastaj vërtetohet e drejta për ndihmë sociale. Zyrtarët e caktojnë shumën dhe llojin e mbështetjes individualisht. Kush jep të dhëna të pavërteta apo hesht diçka e bënë vetën të dënueshëm. Shërbimi social mundet të udhëzoj dhe të vëj kushte. Kur njeriu këto nuk i përmbush, mundet shërbimet të shkurtohen. Pjesëmarrja në bisedat këshilluese është e obliguar. Njeriu është i obliguar, të bëjë gjithçka për me e zvogëluar gjendjen e mjerueshme financiare.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/ndihma-sociale](http://www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/ndihma-sociale)